MARMOFIX
NATURA

Të dhënat e produktit

Përshkrimi i produktit

MARMOFIX Silikon Vollabrieb Aussen: Llaç akrilik silikoni i gatshëm për përdorim me kualitet të shkëlqyeshëm. Përmban agregate me granulacion special të thërmive dhe formon sipërfaqe dekorative të rrafshtë.

- Elasticitet të lartë dhe lidhje të shkëlqyer për substratin
- Dëbueshmëri shumë të mirë të ujit
- Depërtueshmëri të shkëlqyer të avullit të ujit
- Nuk ka nevojë për ngjyrosje të fasadës
- Rezistencë ndaj bazave
- Mbrojtje nga plasaritjet, për dallim nga llaçet çimento gëlqerore

SILIKON VOLLABRIEB aussen

Përdorime të rekomanduara

MARMOFIX Silikon Vollabrieb Aussen mund të aplikohet në të gjitha llojet e materialeve ndërtimore si llaçe, beton, pllaka çimentoje, pllaka gipsi, etj. Falë elasticitetit të lartë dhe lidhjes së shkëlqyer ndaj substratit, është gjithashtu shtresë e fundit ideale për fasada të jashtme me izolim termal.

...GARANTIERTE
QUALITÄT!

Marmofix DOOEL Chelopek, Brvenica
Address: 101 Str, No. 3, Chelopek, 1216
Tetovo, R. North Macedonia
Tel: +389 75 211 222

www.marmofix.ch

MARMOFIX
NATURA

Të dhënat teknike
SILIKON VOLLABRIEB Aussen

Karakteristika teknike

Rrëshirë	Kopolimer akrilik; rrëshirë silikoni
Dendësia	1,80±0,03 gr/ml
Depërtueshmëria e avullit të ujit	V1(EN ISO 7783-2, V1: e lartë Sd<0.14m)
Depërtueshmëria e ujit	W3(EN 1062-3, W3: e ulët w< 0.1 kg/m2h0.5)
Ngjitja	0.4 MPa (EN 1542)
Reaksioni ndaj zjarrit	Euroklasa C
Harxhimi	1.0mm 2,2kg/m2 1.5mm 2,5kg/m2 2.0mm 3,0kg/m2
Tharja	4-6 orë (23°C dhe 50% R.H.)
Nuancat	E disponueshme në ngjyrë të bardhë dhe qindra nuanca tjera bazuar në SISTEMIN E NGJYROSJES MARMOFIX (MARMOFIXTINTING SYSTEM (MTS)
VOC (Komponime të avullueshme organike)	Vlera kufitare për kategorinë e këtij produkti "mure të jashtme me substrate minerale" A/c është 40g/l (2010). Produkti përmban maksimum 39g/l.

Përgaditja e substratit dhe instruksione për aplikim

- **Përgaditja e substratit**
  Substrati duhet të jetë i pastër, i thatë dhe të mos përmbajë material defektiv dhe të ngjitur dobët për sipërfaqen si për shembull pluhur, yndyrë, kripë, etj. Sipërfaqet e reja dhe vjetra duhet të impregnohen me **VORANSTRICH VA-150 Grund**.
  Sipërfaqet me myshk dhe alga duhet të pastrohen/dezinfektohen para aplikimit të astarit.

- **Përgaditja dhe aplikimi**
  Metoda e aplikimit: Mistri çeliku
  Hollues: Ujë
  Hollimi: gatshëm për përdorim
  MARMOFIX Silikon Vollabrieb Aussen zakonisht aplikohet në një shtresë.
  Para përdorimit, llaçi duhet të përzihet me përzierës elektrik dore, dhe nëse është e nevojshme, duhet të hollohet me një sasi të vogël uji për të fituar konzistencë të mirë. Ngjyra e llaçit duhet të kontrollohet para përdorimit.
  MARMOFIX Silikon Vollabrieb aussen aplikohet me mistri çeliku në trashësi të njejtë sa madhësia e kokrrës. Mund të strukturohet sipas temperaturës dhe lagështisë nga moment i aplikimit dhe për 15-20 minuta më pas. Pamja e fundit fitohet duke punuar me mistri plastike, me lëvizje horizontale, vertikale, ose rrethore derisa masa e aplikuar është e lagësht dhe e punueshme.
  Aplikimi nuk duhet të kryhet në temperatura mes +5°C dhe mbi +30°C. Gjatë dhe pas të gjitha aplikimeve, produktet duhet të mbrohen nga ndikimet atmosferike. Veglat duhet të lahen me ujë menjëherë pas përdorimit.

Përdorimi dhe ruajtja

Duhet të mbahet larg fëmijëve. Nuk nevojiten masa të veçanta gjatë punës me **MARMOFIX Silikon Vollabrieb Aussen**. Përdorni doreza mbrojtëse, syze mbrojtëse, dhe maskë. Në rast kontakti me sytë ose lëkurën, lani me sasi të bollshme të ujit, dhe sipas nevojës kërkoni ndihmë mjekësore.
Mbetjet e produktit duhet të hudhen sipas rregullave lokale. Nuk duhet të hudhet në kanalizime apo mjedis. Mbetja e thatë ose e ngurtësuar mund të hudhet si mbetje nga vendi i punëve ndërtimore ose si mbeturinë shtëpiake.
MARMOFIX Silikon Vollabrieb Aussen duhet të ruhet në temperatura mes +5 °C dhe +25 °C si dhe larg dritës së diellit. Në kovat origjinale të pahapura nën kushtet e lartëpërmendura, **MARMOFIX Silikon Vollabrieb Aussen** mund të ruhet për 24 muaj.

Paketimi

Kova 25 kg